

kalimin e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të Hysen Dapi truall me sipërfaqe 91.247 m²”.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, rezulton se, me aplikimin 23.06.2014, dhe nr. 97787, datë 18.12.2015, të kryer për pajisje me dokument pronësie mbi pasurinë e përcaktuar në titullin e pronësisë, Vendimin nr. 136, datë 26.06.2008, të ZRKKP, Qarku Tiranë, është kërkuar ZVRPP, Tiranë, mundësimi i rregjistrimit të pasurisë sikundër përcaktuar në dispozitivin e vendimit gjyqësor të lartpërmendur, si dhe lëshimi i dokumenteve të pronësisë për këtë pasuri. Në kushtet e mosekzekutimit të detyrimit të vendosur nga Gjykata, Institucioni i Avokatit të Popullit me rastin e pranimit për shqyrtim të rastit, ka kërkuar ZVRPP, Tiranë, me Shkresën nr. nr.K3/H2-2 prot, datë 27.02.2015, dhënien e informacionit dhe shkaqeve të cilat justifikojnë mosekzekutimin e detyrimit të vendosur.

Ndërhyrja juaj, z.Kryeregjistruer, pranë ZVRPP, Tiranë, me Shkresën nr. 2241/1 prot, datë 13.03.2015, ka bërë, që kjo Zyrë, të kthej përgjigje Avokatit të Popullit, me Shkresën nr. 7624 Prot, datë 07.04.2015, në të cilën nuk jepet informacioni i kërkuar me pretendimin se kërkohen të dhëna më të sakta si; numri i aplikimit i kryer prej ankuesit, pasi në emër të tij nuk figurojnë të dhëna në sistemin e rregjistrimit. Përkundër këtij qëndrimi, të cilin e konsiderojmë të parregullt dhe mungesë vullneti për bashkëpunim, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rikërkuar informacionin me Shkresën nr. nr.K3/H2-7 prot, datë 09.10.2015, për të cilin ende nuk kemi marrë përgjigje, edhe pse është konsumuar afati ligjor për kthimin e saj, sikundër parashikuar në nenin 19 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar. E vlerësojmë qëndrimin e mbajtur prej ZVRPP, Tiranë, në shkelje të detyrimit për bashkëpunim, për shkak se, ZVRPP, Tiranë, ka të administruar aplikimet 23.06.2014, dhe nr. 97787, datë 18.12.2015, të kryera prej ankuesit (sikurse përmendur nga Ju z.Kryeregjistruer në Shkresën nr. 4609/1 prot, datë 15.06.2015, drejtuar ZVRPP, Tiranë) dhe se për këtë çështje është nxjerr Urdhëri nr.342, datë 09.03.2015, “Për kufizimin e veprimeve” prej Regjistrueses së ZVRPP, Tiranë, lënë në fuqi nga ana juaj me aktin, Urdhërin nr.523, datë 19.06.2012, “Për refuzimin e kërkesës së z.Hajdin Qevani për regjistrimin e Vendimit nr.136, datë 26.06.2008, të ZRKKP, Qarku Tiranë”, kështu që, punonjësit e ZVRPP, Tiranë, nuk mund dhe nuk duhet të shprehin se ; “kërkohen të dhëna më të sakta...” për të mundësuar dhënien e informacionit të kërkuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit.

Edhe pse Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Privat, Zyra Përmbartimore “Strati Bailiff Service” Sh.p.k., ka lajmëruar për detyrimin e vendosur, si dhe urdhëruar më tej për zbatimin e tij, konstatohet se, ZVRPP, Tiranë, në Shkresën nr.7945 prot, datë 09.03.2015, ka vijuar mbajtjen e qëndrimit për mospërmblidhjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata, me pretendime sikundër shprehur në pjesën përshkruese të Urdhërit nr.342, datë 09.03.2015, “Për kufizimin e veprimeve”, apo Urdhërin nr.523, datë 19.06.2012, “Për refuzimin e kërkesës së z.Hajdin Qevani për regjistrimin e Vendimit nr.136, datë 26.06.2008, të ZRKKP, Qarku Tiranë”, të nxjerr nga ana juaj z.Kryeregjistruer. Përpos këtij qëndrimi të mbajtur nga ana e ZVRPP, Tiranë, pala gjyqëfituese i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për ; “Konstatimin e cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr.8736, datë 24.07.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë”. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 1, datë 22.09.2015, e ka pranuar atë, duke

vlerësuar të paarsyeshëm qëndrimin e mbajtur prej ZVRPP, Tiranë, në tejzgjatjen e regjistrimit e pasurisë së paluajtshme konform vendimit gjyqësor. Pretendimi i ZVRPP, Tiranë, se regjistrimi nuk mund të kryhet prej saj pa shmangur mbivendosjen e pronave, nuk është marrë në konsiderat prej Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vlerësuar se :

“Gjykata vlerëson së çështja nuk paraqet kompleksitet ligjor, duke qenë se zgjidhja e problemit faktik që ekziston në regjistrimin e pronës nga ana e ZVRPP, Tiranë, nuk e bën çështjen komplekse në atë shkallë saqë të përbëjë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se veprimi që duhet të kryhet nga pala debitorë nuk ka kosto financiare, që të mund të pengojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja konkrete nuk paraqet rrethana apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit”.

Më tej, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se sjellja e ZVRPP, Tiranë, duke kryer veprimin e regjistrimit të pronës me kufizim, nuk është zgjidhje e çështjes dhe as ekzekutim i vendimit gjyqësor. Kjo Gjykatë, referuar qëndrimin të shprehur prej ZVRPP, Tiranë, se do të duhet zhvillimi i një tjetër procesi gjyqësor për zgjidhjen e mbivendosjes së pronës, ka çmuar se; *“Zhvillimi i një procesi tjetër gjyqësor apo administrative do të çënonte edhe më tej kërkuesen në realizimin e së drejtës së saj për të qenë pronare dhe për të ushtruar efektivisht të drejtën e pronës. Për këtë arsye, i takon palës debitorë të gjej mjete të tjera për të ekzekutuar vendimin gjyqësor. Është detyrim i debitorit që në çështjen konkrete të gjej mundësitë e duhura për të regjistruar pronën në emër të kërkueses sipas vendimit gjyqësor dhe jo të paraqesë pengesa për të mos regjistruar pronën në emër të kërkueses”.*

Për zgjidhjen teknikisht të situatës së krijuar, ankuesi Hajdin Qevani, ka kërkuar pranë Njësisë Administrative, Kashar, përgatitjen e relacionit hartografik me qëllim kryerjen e korigjimit hartografik përkatës si dhe mundësimin e regjistrimit të vendimit gjyqësor të lartpërmendur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Në përgjigje të kërkesës së ankuesit, rezulton se, Njësia Administrative, Kashar, me Shkresën nr.1228/2 prot, datë 11.12.2015, drejtuar ZVRPP, Tiranë, konfirmon përgatitjen dhe dërgimin pranë saj të relacionit hartografik i cili zgjidh çështjen e mbivendosjes së pronës dhe hap rrugën e regjistrimit të pronës sipas Vendimit nr. 136, datë 26.06.2008, të ZRKKP, Qarku Tiranë.

Pra, edhe pse ka ekzistuar mundësia e zgjidhjes së çështjes të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në favor të pronarit, Regjistruesi i ZVRPP, Tiranë, pa shkak, nuk ka ushtruar funksionin sikurse parashikuar në nenin 30 të Ligjit nr.33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,

“Korigjimi i hartës kadastrale dhe shtesat e reja.

Regjistruesi, në çdo kohë me ose pa kërkesën e personave të interesuar, mund:

a) të kërkojë që të bëhet një studim/rilevim për çdo pasuri të paluajtshme, për qëllime të këtij ligji, dhe, pasi të ketë njoftuar personat e interesuar, mund të korigjojë hartën kadastrale si rezultat i studimit/rilevimit të lartpërmendur;

b) të korigjojë çdo gabim teknik apo material në hartën kadastrale, nëse nuk cenohen interesat e ndonjë personi, duke vënë në dijeni personat e interesuar apo personat që

kanë të drejta reale mbi sendin;

c) të udhëzojë përgatitjen e një harte të re kadastrale ose të një pjese të saj, në rast dëmtimi apo humbjeje.

ç) të korrigojë me qëllim përmirësimin e hartës kadastrale”,

duke shkelur me këtë rast, të drejtën e pronës së subjektit pronar, parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikundër konstatuar nga Gjykata Kushtetuese me rastin e dhënies së Vendimit nr.1, datë 22.09.2015. Regjistruesi i ZVRPP, Tiranë, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 8736, datë 24.07.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nuk është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privat, drejtësisë dhe i paanësisë, përgjegjshmërisë, eficiencës dhe deburokratizimit, sikurse parashikuar respektivisht në nenin 9, 10, 12, 14, 16 të Kodit të Procedurës Administrative, të detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi. Duke e vlerësuar të parregullt veprimtarinë e ZVRPP, Tiranë, në procesin e shqyrtimit të aplikimit për pajisje me dokumente pronësie me rastin e ekzekutimit të detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 8736, datë 24.07.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të parashikimit të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”, si dhe nenin 21/b, të Ligjit nr.8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDON

Ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Tiranë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit H.Q, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumenteve të pronësisë subjektit pronar.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të Vendimit Gjyqësor nr.2087, datë 07.05.2014, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Kopje të Vendimit Gjyqësor nr.8736, datë 24.07.2013, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Kopje të Vendimit Gjyqësor nr.2762, datë 20.05.2015, të dhënë prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Shkresë nr.6173 prot, datë 14.05.2014, e Shoqërisë Përmbartimore “Strati Bailiff’s Service” Sh.p.k. drejtuar ZQRPP dhe ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr.6631 prot, datë 26.05.2014, e Shoqërisë Përmbartimore “Strati Bailiff’s Service” Sh.p.k. drejtuar ZQRPP dhe ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr.246 prot, datë 12.01.2015, e Shoqërisë Përmbaremore “Strati Bailiff’s Service” Sh.p.k. drejtuar ZQRPP dhe ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr.1305 prot, datë 30.01.2015, e Shoqërisë Përmbaremore “Strati Bailiff’s Service” Sh.p.k. drejtuar ZQRPP dhe ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr.4724/4 prot, datë 26.09.2014, e ZQRPP . drejtuar Shoqërisë Përmbaremore “Strati Bailiff’s Service” Sh.p.k.

Shkresë nr.285/3 prot, datë 21.06.2012, e ZQRPP . drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje e Urdhërit nr.523, datë 19.06.2012, e ZQRPP.

Shkresë nr.s’ka, datë 07.08.2014, e ZVRPP, Tiranë, drejtuar Shoqërisë Përmbaremore “Strati” Sh.p.k.

Vendimin nr.1, datë 21.01.2016, të dhënë nga Gjykata Kushtetuese.

Shkresë nr.1228/2 prot, datë 11.12.2015, e Administratorit të Njësisë Administrative Kashar, drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Kërkesë(aplikim) nr.97787, datë 18.12.2015, e Hajdin Qevani, kryer ZVRPP, Tiranë.

Kërkesë(aplikim) nr.33621, datë 23.06.2014, e Albi Halili, kryer ZVRPP, Tiranë.

Kërkesë(aplikim) nr.29198, datë 13.06.2014, e Albi Halili, kryer ZVRPP, Tiranë.

Kërkesë(aplikim) nr.6004, datë 21.01.2016, e Hajdin Qevani, kryer ZVRPP, Tiranë.

Formular ankese, datë 22.01.2016, plotësuar në ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr.7945 prot, datë 09.03.2015, e ZVRPP, Tiranë, drejtuar Bashkisë, Tiranë, etj.

Kartelë pasurie, datë 05.03.2007, lëshuar prej ZVRPP, Tiranë, për pasurinë nr. 68155, vol 18, faqe 159,

Shkresë nr. 4609/1 prot, datë 15.06.2015, e ZQRPP drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr. 403/1 prot, datë 22.01.2015.06.2015, e ZQRPP drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr. K3/H2-7 prot, datë 09.10.2015, e Avokatit të Popullit drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr. K3/H2-2 prot, datë 27.02.2015, e Avokatit të Popullit drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Shkresë nr.7624 prot, datë 07.04.2015, e ZVRPP, Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Shkresë nr.2241/1 prot, datë 13.03.2015, e ZQRPP, Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Shkresë nr.1228 prot, datë 14.10.2015, e Administratorit të Njësisë Administrative Kashar, drejtuar Hajdin Qevani.

KOMISIONERE

Etilda GJONAJ(SALIU)